



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 26 shkurt 2020

Njoftim për shtyp

Zhvillime më të rëndësishme në institucionet tjera financiare^{1,2} (ITF): tremujori i katërt i vitit 2020

- **Bilanci i aseteve totale të ITF-ve, në tremujorin e katërt të vitit 2020 arriti 138.692 milionë denarë**, që është një rritje prej 4.607 milionë denarë krahasuar me fundin e vitit paraprak. **Struktura e aseteve të ITF-ve** tregon se fondet e pensionit vazhdojnë të kenë pjesën më të madhe në totalin e aseteve prej 64,6%, pasuar nga asetet e kompanive të sigurimeve me një pjesëmarrje prej 19,3%.
- **Në këtë tremujor, asetet e ITF-ve kanë regjistruar rritje mujore dhe vjetore prej 3,4% dhe 12,8%, përkatësisht.** Ndryshimi tremujor në rritje është kryesisht si rezultat i aseteve të rritura në fondet e pensioneve, si dhe nënsektorëve të tjerë, me përjashtim të fondeve të investimeve dhe kompanive të sigurimeve, të cilët shënuan rënie tremujore. Fondet e pensioneve janë nxitësi kryesor i rritjes vjetore, e cila në masë më të vogël plotësohet nga rritja e aseteve të nënsektorëve të tjerë.

Tabela 1. Totali i aktiveve/detyrimeve të ITF-ve³

	Кв.4 2019	Кв.3 2020	Кв.4 2020	Квартални промени		Годишни промени		Структура (Вкупно ОФИ)
				Кв.4 2020/Кв.3 2020		Кв.4 2020/Кв.4 2019		
	Состојби, во милиони денари			милиони денари	%	милиони денари	%	%
1. Останати финансиски институции	122,921	134,085	138,692	4,607	3.4	15,771	12.8	100
1.1 Осигурителни друштва	24,863	27,045	26,803	-242	-0.9	1,940	7.8	19.3
1.2 Пензиски фондови	77,620	84,947	89,585	4,638	5.5	11,965	15.4	64.6
1.3 Инвестициски фондови	8,752	9,451	9,080	-371	-3.9	327	3.7	6.5
1.4 Други ОФИ	11,685	12,642	13,224	582	4.6	1,538	13.2	9.5
1.4.1 Финансиски друштва	4,413	4,671	5,036	365	7.8	624	14.1	3.6
1.4.2 Лизинг друштва	5,657	6,182	6,309	127	2.1	652	11.5	4.5
1.4.3 Друштва за управување со пензиски и инвестициски фондови	1,616	1,789	1,879	90	5.0	263	16.3	1.4

Burimi: BPRMV.

¹ Institucionet tjera financiare përfshijnë: fondet e investimeve, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve, kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.

² Në gusht të vitit 2018, të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2018 janë rishikuar në mënyrë që të zbatohet metodologjia e re në pajtim me Manualin e ri dhe Udhëzimin e ri për statistika monetare dhe financiare të FMN-së nga vitit 2016. Dy ndryshime janë thelbësore. I pari i referohet ndryshimit në trajtimin e instrumenteve financiare të shprehura në „denarë” me klauzolë valutore, të cilat në pajtim me metodologjinë e re, nga kategoria „denarë” rishpërndahen në kategorinë „valutë e huaj”. Ndryshimi i dytë është në paraqitjen e zhvlerësimit të instrumenteve financiar, i cili në vend të kapitalit paraqitet brenda kategorisë „detyrime tjera”. Për më shumë informacione shihni lidhjen në vijim:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf.

³ Për qëllimet e këtij njoftimi, kategoria „ITF-të tjera” përfshin: kompanitë e menaxhimit të fondeve të investimeve dhe kompanitë e menaxhimit të fondeve të pensioneve, kompanitë financiare dhe kompanitë ofrues të lizingut financiar.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Instrumentet më të rëndësishëm në anën e aseteve të ITF-ve** janë investimet në letra me vlerë të borxhit⁴ (pjesëmarrje prej 48,8%) dhe letra me vlerë të kapitalit (pjesëmarrje prej 23,1%), si dhe investimet në valuta dhe depozita (pjesëmarrje prej 14,5%). **Në anën e detyrimeve**, pjesa më e madhe u takon rezervave teknike të sigurimeve dhe llogarive të kapitalit⁵ (pjesëmarrje prej 57,5% dhe 33,9%, përkatësisht).

Tabela 2. Asete/detyrime të ITF-ve, sipas nënsektorëve dhe sipas instrumenteve financiare, T. 4 2020

	Вкупно ОФИ		Пензиски фондови		Осигурителни друштва		Инвестициски фондови		Други ОФИ	
	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)	состојба (во мил. ден.)	учество (во %)
Вкупни средства	138,692		89,585		26,803		9,080		13,224	
Валута и депозити	20,057	14.5	9,066	10.1	6,523	24.3	3,332	36.7	1,136	8.6
Хартии од вредност различни од акции	67,630	48.8	53,305	59.5	10,807	40.3	2,638	29.1	881	6.7
Кредити	9,268	6.7	0	-	184	0.7	9	0.1	9,075	68.6
Акции и останат сопственички капитал	31,980	23.1	27,038	30.2	1,748	6.5	3,083	34.0	110	0.8
Технички резерви на осигурување	1,702	1.2	0	-	1,702	6.3	0	-	0	-
Финансиски деривати	2	-	0	-	0	-	2	-	0	-
Останати средства	5,017	3.6	177	0.2	4,375	16.3	16	0.2	449	3.4
Нефинансиски средства	3,036	2.2	0	-	1,463	5.5	0	-	1,573	11.9
Вкупни обврски	138,692		89,585		26,803		9,080		13,224	
Кредити	7,341	5.3	0	-	93	0.3	9	-	7,239	54.7
Технички резерви на осигурување	79,728	57.5	63,885	71.3	15,843	59.1	0	-	0	-
Останати обврски	4,628	3.3	36	0.0	2,565	9.6	56	0.6	1,971	14.9
Капитални сметки	46,995	33.9	25,665	28.6	8,301	31.0	9,016	99.3	4,013	30.4

Burimi: BPRMV.


- **Sipas instrumenteve**, në anën e aseteve, nxitësi kryesor i rritjes tremujore dhe vjetore janë investimet në letra me vlerë të borxhit, me një kontribut pozitiv në rritjen e investimeve të kapitalit. Nga ana tjetër, valutat dhe depozitat shënuan një rënie tremujore. Në anën e detyrimeve, kontribut më të madh në rritjen tremujore kanë llogaritë kapitale, me një pjesëmarrje pozitive të rezervave teknike të sigurimeve, ndërsa rritja vjetore në masë të madhe është si rezultat i rezerve më të larta teknike të sigurimeve.

⁴ Letrat me vlerë të borxhit (LVB) u referohen letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet sipas klasifikimit ndërkombëtar të instrumenteve financiare, siç është botuar në bilancet dhe pasqyrat e institucioneve tjera financiare.


⁵ Rezervat teknike të sigurimeve përmbajnë: kapitale neto të amvisërive nga rezervat e sigurimit të jetës, kapital neto të amvisërive në fondet e pensione dhe prime të parapaguara dhe rezerva ndaj pretendimeve të papaguara (sigurimi jo-jetë).



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë




Burimi: BPRMV.



Zhvillime më të rëndësishme në ITF-të, sipas llojit të instrumentit

- Në tremujorin e katërt, **totali i aktiveve të фондеве të pensioneve (të detyrueshëm dhe vullnetarë)** shënojnë një rritje prej 5,5% në bazë tremujore. Sipas instrumenteve, rritja tremujore është kryesisht si rezultat i investimeve të rritura në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit, në kushte të rënies në valuta dhe depozita. Norma vjetore e rritjes është 15,4% dhe në masë të madhe është si rezultat i investimeve më të mëdha në letra me vlerë të borxhit (pjesëmarrje prej 65%), me një kontribut më të vogël pozitiv të investimeve në letra me vlerë të kapitalit dhe instrumenteve tjera. Në anën e detyrimeve, rritja në bazë tremujore shpjegohet me llogaritë më të larta kapitale dhe rezervat teknike të sigurimit, ndërsa rritja vjetore në masë të madhe është si rezultat i rezervave të rritura teknike të sigurimit.




Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Këtë tremujor, **totali i aktiveve të kompanive të sigurimeve**⁶ u ul me 0,9% në bazë tremujore, kryesisht për shkak të pretendimeve në bazë të rezervave teknike të sigurimeve në bazë të risigurimit, me një kontribut më të vogël negativ të pretendimeve tjera dhe aseteve jofinanciare. Në drejtim të rritjes së aseteve ndikuan vendosjet në valuta dhe depozitat, si dhe investimet në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit. Në nivel vjetor, asetet e kompanive të sigurimit janë rritur për 7,8%, që në masë të madhe është si rezultat i rritjes në letrat me vlerë të borxhit. Në anën e detyrimeve, rënia në bazë tremujore është kryesisht për shkak të huave të reduktuara, detyrimeve tjera dhe rezervave teknike të sigurimeve. Bartësi kryesor i rritjes vjetore janë rezervat teknike të sigurimeve.




- Në tremujorin e katërt, **totali i aseteve të фондеve të investimeve**⁷ shënojnë një rënie tremujore prej 3,9%, e cila thuajse tërësisht shpjegohet me vendosjet e reduktuara në valuta dhe depozita, pjesërisht të neutralizuar me investimet e rritura në letra me vlerë të borxhit dhe kapitalit. Krahasuar në bazë vjetore, asetet e фондеve të investimeve shënojnë rritje prej 3,7%, me një kontribut më të madh në rritjen e letrave me vlerë të borxhit dhe kapitalit, në kushte të rënies së vendosjeve në valuta dhe depozita. Në anën e detyrimeve, rënia tremujore u nxit nga llogaritë e reduktuara të kapitalit, ndërsa në bazë vjetore llogaritë e kapitalit shënojnë rritje.

⁶ Në BPRMV aktualisht raportojnë gjashtëmbëdhjetë kompani sigurimesh të cilat janë në regjistrin e Agjencisë për Mbkëqyrje të Sigurimeve (ASO), prej të cilave njëmbëdhjetë janë për sigurim jo-jetë dhe pesë janë për sigurim jetë.

⁷ Regjistri i Komisionit të Letrave me Vlerë (KLV) aktualisht përfshin gjashtëmbëdhjetë фонде të hapura të investimit dhe njëmbëdhjetë фонде private të investimit, me ç'rast në BPRMV raportojnë njëzet e katër фонде.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV.

- Në fund të dhjetorit, **totali i asetëve të ITF-ve tjera**^{8,9}, shënuan rritje në bazë tremujore dhe vjetore prej 4,6% dhe 13,2%, përkatësisht, si rezultat i aktivitetit të rritur huadhënës të kompanive financiare dhe kompanive ofrues të lizingut financiar. Aktiviteti huadhënës i kompanive financiare dhe kompanive ofrues të lizingut në fund të vitit 2020 arriti 9.073 milionë denarë, me një rritje tremujore dhe vjetore prej 5,7% dhe 14,4%, përkatësisht. Nxitësi kryesor i rritjes në të dyja bazat është aktiviteti huadhënës i kompanive financiare, me një kontribut pozitiv por më të vogël në rritje të kompanive për lizing. Në anën e detyrimeve, ndryshimi tremujor dhe vjetor shpjegohet me detyrimet më të larta në bazë të kredive të marra (kryesisht në valutë të huaj) dhe llogarive të rritura kapitale.



Burimi: BPRMV.

⁸ Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2014, përfshihen të dhëna mbi raportimin e kompanive financiare dhe kompanive ofrues të lizingut financiar. Të dhënat aktualisht mbulojnë njëzet e katër kompani financiare dhe shtatë kompani ofrues të lizingut financiar.

⁹ Në tremujorin e katërt të vitit 2017, në seritë të të dhënave është përfshirë një kompani e re financiare (një shtëpi kursimi e cila është reregjistruar në kompani financiare), ndryshim i cili kishte ndikim mbi normat vjetore të ndryshimit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Rishikim i të dhënave

Të dhënat për zhvillimet në ITF-të në këtë njoftim përmbajnë rishikime të të dhënave për tremujorin e tretë të vitit 2020, në mënyrë të marrjes së informacioneve të reja, të korigjuara dhe të dhëna nga raportuesit. Këto rishikime nuk shkaktuan ndryshime të konsiderueshme në të dhënat e publikuara paraprakisht dhe kryesisht vijnë nga përmirësimi i mbulimit dhe cilësisë së raportimit.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna tremujore për asetet dhe detyrimet e institucioneve financiare <http://nbrm.mk/ns-newsarticle-bilans-i-pregledi-na-finansiskite-institucii-kvartalni-podatoci.nspj>

Shpjegime metodologjike:

http://nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesit: http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Të dhëna tremujore për asetet dhe detyrimet e institucioneve financiare: 28 maj i vitit 2021 (mesatare referuese me tremujorin e parë të vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).